



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2022:258338
Datë: 10.10.2024
Numri i dokumentit: 06278648

C.nr.1693/22

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtarin Fuad Haliti, në çështjen juridike kontestimore të paditëses Xh. V. nga M. të cilën sipas autorizimit e përfaqëson avokat Sheremet Ademi nga Mitrovica, kundër të paditurës Komuna e Mitrovicës Jugore, me objekt kontesti kompensim i pagës jubilarë dhe pages përcjellëse, jashtë seance me datë 10.10.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. KONSTATOHET se është tërhequr padia me numër **C.nr....** e paditëses Xh. V. nga M., kundër të paditurës Komuna e Mitrovicës Jugore, me objekt kontesti kompensim i pagës jubilarë dhe pages përcjellëse.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Arsyetim

Paditësja Xh. V. nga M., me datën ..., pranë kësaj gjykate ka paraqitur padi kundër të paditurës Komuna e Mitrovicës Jugore, për kompensim i pagës jubilarë dhe pages përcjellëse.

I autorizuari i paditëses me parashtrësën e datës ... ka njoftuar gjykatën se e tërheqin padinë në këtë çështje kontestimore dhe i ka kërkuar shpenzimet procedurale me pretendimin se është bërë përmbushja e detyrimit mbas ushtrimit të padisë.

Në bazë të nenit 261 paragrafi 1 i LPK-së parashihet që *“Paditësi mund ta tërheqë padinë pa pëlqimin e të paditurit deri në momentin në të cilin i padituri e paraqet në gjykatë përgjigjen në padi.”*

Lidhur me kërkesën e paditëses për kompensimin e shpenzimeve procedural, gjykata konstaton se e njëjta nuk ka prezentuar dëshmi se kompensimi i është bërë pas ashtrimit të padisë, andaj gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktvendimi.

Andaj gjykata duke u bazuar në nenin 261 paragrafi 1 i LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
C.nr.1693/22, datë: 10.10.2024

Gjyqtari
Fuad Haliti

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.